

Raport mbi sektorin e urbanizmit në Komunën e Prizrenit

Mars 2010

Përmbajtja:

Urbanizmi dhe Planifikimi Hapësinor në Komunën e Prizrenit

- **Hyrje**
 - **Të gjeturat kryesore të raportit**
 - **Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor**
 - **Kompetencat**
 - **Buxheti**
 - **Të hyrat vetanake**
 - **Planet rregullative**
 - **Plani Zhvillimor Komunal**
 - **Kërkesat e shqyrtuara (dhënia e lejeve)**
 - **Ndërtimet pa leje**
 - **Ndërtimi në Lagjen Dardania**
 - **Prevala**
 - **“Kampingu veror”**
 - **Raportet mes Komunës së Prizrenit dhe Institutit për Mbrojtjen e Monumenteve Kulturore në Prizren**
 - **Antenat e telefonive mobile**
-

Urbanizmi dhe Planifikimi Hapësinor në Komunën e Prizrenit

Hyrje

Një nga problemet më të theksuara në Komunën e Prizrenit janë të shprehura në sektorin e urbanizmit dhe planifikimit hapësinor. Kjo për faktin se ky qytet ngërthen në vete një numër të madh të objekteve me rëndësi të madhe historike, zona të gjëra të banuara (numër i madh i të cilëve pa planifikim urban) dhe një sërë elementesh tjera që e bëjnë mjaft të komplikuar dhe të vështirë çështjen e rregullimit të mirëfilltë urbanistik dhe planifikimit të mirë hapësinor në Komunën e Prizrenit.

Si e tillë, sektori i urbanizmit dhe planifikimit hapësinor në Komunën e Prizrenit gjithnjë ka qenë në qendër të vëmendjes dhe me ndikim të jashtëzakonshëm në jetën e qytetarëve. Krahas kësaj, sfidat që u dalin udhëheqësve të këtij sektori shumë herë kanë çuar në zëvendësimin dhe ndryshimin e udhëheqësve të këtij sektori.

Aktualisht, ndër çështjet problematike që kërkojnë zgjidhje akute në sektorin e urbanizmit dhe planifikimit hapësinor në Prizren mund të përmenden:

- Rritje e kapaciteteve humane dhe profesionale të Drejtorisë për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor;

- Finalizimi i procesit të hartimit të Planit Zhvillimor Komuna;
- Hartimi i planeve rregullative për pjesë të qytetit;
- Gjetja e zgjidhjes për vendbanimet joformale;
- Respektimi i vendimeve dhe lejeve të lëshuara nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor (efikasiteti i Drejtorisë për Inspektorate);
- Trajtim dinjitoz dhe institucional për objektet e trashëgimisë kulturore;
- Krijim të mundësive dhe hapësirave të mjaftueshme për investitorë potencial vendorë dhe të huaj;

Në këtë kuadër Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka hartuar një raport përkitazi me sektorin e urbanizmit në Komunën e Prizrenit.

Në këtë raport janë të përfshirë një spektër i gjerë nga fushë veprimtaria e Drejtorisë për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor të Komunës së Prizrenit dhe çështjet tjera që ndërlidhen me kompetencat e kësaj drejtorie. Në këtë raport janë të përfshirë edhe të dhëna mbi buxhetin, stafin dhe kompetencat e kësaj drejtorie, problemet që janë të shfaqura në Komunën e Prizrenit nga fusha e urbanizmit dhe planifikimit hapësinor dhe rekomandimet e KDI-së në funksion të rritjes së efikasitetit të punës së kësaj drejtorie dhe në funksion të përmirësimit të kualitetit të jetës së qytetarit të Komunës së Prizrenit.

4

Të gjeturat kryesore të raportit

Gjatë zhvillimit të intervistave me qëllim të hartimit të kësaj analize me zyrtarë të Komunës së Prizrenit, drejtorë të drejtorive komunale, ekspertë të urbanizmit, arkitektë, etj., ka dalë në pah se në Komunën e Prizrenit bëhet fjalë për koordinim jo të mirë të veprimeve në mes drejtorive komunale në njërin anë dhe organeve komunale e Institutit për Mbrojtjen e Monumenteve në anën tjetër gjithnjë me qëllim të kontrollit të cilësisë së ndërtimit në qytet, përputhjes së ndërtimeve me planet përkatëse, mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, etj.

Një e gjetur tjetër e raportit është edhe kapaciteti i ulët i Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor për të përfunduar me sukses të gjitha punët që shfaqen para saj në kuadër të kompetencave të përcaktuara për këtë drejtori. Bëhet fjalë për hartimin e planeve rregullative për pjesë të ndryshme të qytetit dhe punëve tjera të ngjashme. Andaj në mungesë të kapaciteteve të mjaftueshme, Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor është detyruar që hartimin e planeve rregullative për zona të caktuara të qytetit dhe hartimin e Planit Zhvillimor Komunal gjithnjë t'ua "besojë" kompanive private gjë e cila bart kosto jashtëzakonisht të lartë për buxhetin e Komunës së Prizrenit.

Mungesa e kapaciteteve vjen në shprehje edhe në Drejtorinë e Inspektorateve, saktësisht në Sektorin për Urbanizëm të kësaj drejtorie. Në komunën e dytë më të madhe të Kosovës janë të punësuar vetëm 4 inspektorë të ndërtimit, nga gjithsej 12 të punësuar sa kanë qenë në Drejtorinë e Inspektorateve, duke

përfshirë edhe drejtorin. Ky fakt pamundëson efikasitetin e institucioneve, rrezikon funksionimin organit që është përgjegjëse për kontroll të ndërtimeve në Komunën e Prizrenit dhe bashkë me këtë rrezikon edhe jetën e qytetarëve të Komunës së Prizrenit.

Problematike në Prizren paraqitet edhe raporti, gjegjësisht bashkëpunimi në mes organeve të Komunës së Prizrenit dhe Institutit për Mbrojtjen e Monumenteve, me ç'rast numër i madh i ankesave të këtij Instituti kanë has në veshë të shurdhë në organet kompetente të Komunës.

Ndërkohë që, Prevalla paraqet "majën e ajsbergut" në aspektin më negativ të mundshëm për të gjitha institucionet e vendit. Komuna e Prizrenit, Kuvendi i Kosovës, Avokati i Popullit, Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor janë disa nga palët e përfshira në lëmshin e quajtur Fshati Turistik "Prevalla".

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor

Kompetencat

Gjatë mandatit 2007 – 2009 të Qeverisë Muja, në Komunën e Prizrenit në një ombrellë të vetëm ka funksionuar Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor.

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor, si organ administrativ, në kuadër të kompetencave të veta ligjore kryen këto punë: zhvillon procedurat lidhur me lëshimin e akteve mbi kushtet urbanistike, leje urbanistike, aktvendime mbi lokacionin hapësinor dhe të lejeve ndërtimore, bënë vazhdimin e lejeve ndërtimore, pranimin teknik të objekteve, legalizimin e objekteve, lëshon leje për mbindërtim, aneks ndërtim, rekonstruim, leje për rrënimin e objekteve si dhe harton plane hapësinore dhe përgatitë projektvendime për Plane Rregulluese Urbane, dhe i procedon Kuvendit të Komunës për miratim.


Përveç këtyre kompetencave stafi i kësaj drejtori bënë edhe trajtimin e lëndëve për drejtoritë tjera si dhe mbikëqyrjen dhe pranimin teknik të punimeve për projektet kapitale. Në këtë kontekst Drejtori i Urbanizmit formon një komision ku përfshihet edhe stafi i drejtorisë që realizon projektin.

Pritet që Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor edhe gjatë mandatit të ri të Qeverisë Muja të jetë me funksion dhe kompetenca të ngjashme.

Buxheti

Nga totali i buxhetit të Komunës së Prizrenit prej 25,649,756.00 € Drejtorisë për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor i takojnë 1.249.682 €


Nga këto, për paga dhe mëditje për stafin prej 12 të punësuarish janë paraparë 35,033.00 € për mallra dhe shërbime 14,649.00 € dhe për investime kapitale janë paraparë gjithsej 1,200,000.00 €



6

Të hyrat vetanake

Në vitet 2008 – 2009 Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor ka siguruar të hyra vetanake në vlerë prej 1,651,453.08 €



Nga këto, 1,426,037 € të hyra të siguruara nga kontributet për rregullimin e tokës ndërtimore, 8,494 € të siguruara nga legalizimi dhe të hyra tjera të paraqitura në tabelën e mësipërme.

Planet rregullative

Një nga kushtet themelore që duhet t'i ketë një qytet, në mënyrë që ajo të jetë funksional dhe e planifikuar mirë është hartimi i planit zhvillimor urban dhe i planit zhvillimor komunal dhe hartimi i planeve rregullative për pjesët e qytetit. Vetëm me hartimin dhe zbatimin e plotë të këtyre dokumenteve një qytet mund të ofrojë kushte të mirëfillta banimi për qytetarët e saj.

Kjo vlen posaçërisht për qytetin e Prizrenit e cila shquhet për lagjet e vjetra të saj të ndërtuara pa respektuar kriteret urbanistike të nevojshme.

Mirëpo, ajo çka është shqetësuese për Prizrenin është se, megjithëse tashmë ekzistojnë të gjitha kushtet e nevojshme për zgjerim të planifikuar të qytetit, edhe më tej vazhdon trendi i ndërtimeve të paplanifikuara jo vetëm në qendër të qytetit por edhe në zona periferike të saj. Për më tepër, me ritme shumë të shpejta po ngrënë shtat lagjet “joformale”.

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor ka evidentuar lagjet “Jeta e Re”, “Bajram Curri”, “Tusus”, “Petrovë” dhe “Kurila” si vendbanime joformale dhe në planin e saj të punës për periudhën 2010 – 2013 ka vënë si objektivë trajtimin e këtyre lagjeve dhe hartimin e planeve rregullative për to.

Sidoqoftë, edhe pse në këto lagje “joformale” jetojnë me mijëra banorë dhe janë ndërtuar e po ndërtohen me qindra objekte banimi, Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor i Komunës së Prizrenit ende nuk ka ndërmarrë hapa të nevojshme, e që janë urgjente, në mënyrë që lagje të tëra të

qytetit t'i kthehen normalitetit urbanistik. Ndërkohë që gjatë 2 viteve të kaluara të mandatit të Qeverisë Muja, DUPH ka hartuar këto plane rregullative:

- Plani Rregullues Urban për Konzervim dhe Zhvillim të Zonës Historike të Prizrenit (Zona e parë e mbrojtur);
- Plani Rregullues Urban “Dardania 2”;
- Plani Rregullues Urban “Lakuriqi Verior”
- Plani Rregullues Urban “Qendra e Re”;
- Plani Rregullues Urban “Lakuriqi”;
- Plani Rregullues Urban “Industri e lehtë”.

Për më tepër, me arsyetimin se Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor nuk ka staf dhe buxhet të mjaftueshëm, planet rregullative sikurse edhe Plani Zhvillimor Komunal hartohen nga kompani private të cilat me vete bartin kosto të mëdha dhe ngarkesë për buxhetin e Komunës së Prizrenit.

Plani Zhvillimor Komunal

Plani Zhvillimor Komunal mund të cilësohet si storje e suksesit në Komunën e Prizrenit. Në vitin 2008 Komuna e Prizrenit, pas anulimit radhazi të tre tenderëve, zgjodhi hartuesin e Planit Zhvillimor Komunal. Në bazë të kësaj, fituesit të tenderit iu dha një afat prej 18 muajsh, apo 210 ditë pune, që të hartojë Planin Zhvillimor Komunal të Prizrenit duke inkorporuar në këtë plan 74 fshatra dhe qytetin e Prizrenit me gjithsej 640 km².

Aktualisht, ky plan është në fazën e finalizimit, ku rreth 80% e punës është përfunduar, dhe gjatë javëve në vijim pritet të paraqitet për debat publik, ku pasi të përfshihen në plan kontributet eventuale të publikut, ajo pritet t'i dërgohet Kuvendit të Komunës së Prizrenit për miratim.




Sidoqoftë, është evidente një vonesë në finalizimin e të gjitha procedurave rreth PZHK të Prizrenit. Mirëpo kjo vonesë, sipas hartuesve të këtij dokumenti, ka ardhë si pasojë e pamundësisë së tyre për të siguruar me kohë dokumentet e nevojshme nga institucionet e ndryshme të vendit.

8

Kërkesat e shqyrtuara (dhënia e lejeve)

Nga të dhënat e paraqitura në Raportin e Punës për 2008 – 2009 të Drejtorisë për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor shihet se gjatë kësaj periudhe kjo drejtori ka pranuar gjithsej 2358 kërkesa.



Nga këto 1270 janë miratuar, 460 janë refuzuar, 207 të hedhura poshtë, në 55 nga këto kërkesa procedura është pezulluar, dhe gjithsej 358 kërkesa janë në procedurë e sipër pranë kësaj drejtorie.

Ndërtimet pa leje

Në komunën e Prizrenit janë evidente në masë të madhe edhe ndërtimet pa leje, fenomen ky i shprehur për një dekadë të tërë dhe si i tillë nuk ka të ndalur.

Nga ana e DUPH-së është konfirmuar se ka ndërtime të tilla në Komunën e Prizrenit mirëpo kompetent në ndaljen e këtyre ndërtimeve është Drejtorja e Inspektorateve e cila është treguar e pafuqishme në këtë segment. Sektori i ndërtimtarisë, në kuadër të Drejtorisë së Inspektoratit, jep një pasqyrë të përgjithshme për punën një vjeçare të këtij sektori.



Inspektimet

Ky sektor, në kuadër të punës së tij mbi inspektimet e objekteve ndërtimore, ka kryer gjithsej 738 inspektime të tilla, prej të cilave ka përpiluar 574 procesverbale nga ato inspektime. Si pjesë e inspektimeve për ndërtimet e objekteve të ndryshme ky sektor ka lëshuar 333 aktvendime për ndërprerjen e punimeve, mirëpo mbetet edhe një pjesë e madhe e mbindërtimeve me gjithsej 24, shtim ndërtimeve me gjithsej 36 dhe mure rrethuese me gjithsej 12 të tilla.

Ndërtimet e ndaluara dhe të rrënuara

Përveç inspektimeve në ndërtime ky sektorë ka intervenuar në 29 raste për rrënimin e objekteve ndërtimore pa leje karshi 87 rasteve që janë evidentuara si ndërtime pa leje, ndërsa ka intervenuar në ndaljen e punimeve apo rrethimin e tyre me shirit në vetëm 6 raste.

Procedimi i shkelësve në gjykata

Sektori i ndërtimtarisë përveç inspektimeve të shumta në ndërtimet pa leje, më qëllim të penalizimit të shkelësve të ndërtimeve që hasen gjatë inspektimit, në Gjykatën për Kundërvajtje ka proceduar gjithsej 61 lëndë ndërsa kjo Gjykatë ka shqyrtuar 95 lëndë dhe ka lëshuar 39 aktvendime për rrënimin e objekteve ndërtimore. Kurse dënimet e lëshuara nga Gjykata për Kundërvajtje kapin shumën prej 23.650 €

Nga kjo pasqyrë e paraqitur për punën një vjeçare të këtij sektori mund nxjerrim një shpërputhje në mes të ndërtimeve pa leje dhe atyre të rrënuara, ku është intervenuar vetëm në 29 raste kundrejt 87 rasteve të ndërtimeve pa leje në lagje të ndryshme të Prizrenit, por mbetet edhe një numër i madhe i mbindërtimeve dhe shtim ndërtimeve me gjithsej 24 përkatësish 36 raste të tilla.

Mungesa e sigurisë personale të inspektorëve, numri i vogël i të punëtorëve, pagat e ulëta, mungesa e automjeteve dhe teknikës adekuate, janë vetëm disa nga nevojat e këtij sektori për të pas sukses më të madh në ruajtjen e vlerave urbanistike të qytetit të Prizrenit. Megjithatë për të pas sukses në këtë drejtim, qenësore është ekzistimi i vullnetit politik, vullnet i cili nuk ka qenë në nivel të duhur gjatë viteve të fundit.

Ndërtimi në Lagjen Dardania

Në mbledhjen e datës 30 prill 2009, Kuvendi i Komunës së Prizrenit mori vendim për ndryshimin e Planit Urban të Jaglicës (Dardani), me qëllim të ndërtimit të ndërtesës shumëkatëshe ku do të vendoseshin familjet e dëshmorëve dhe rastet sociale. Vendi ku parashihej ndërtimi i kësaj banese, sipas planit të vjetër urban për këtë lagje parashihej si zonë e gjelbër.

Marrja e një vendimi të këtillë nga Kuvendi i Komunës së Prizrenit, pa i konsultuar banorët e lagjes, ka sjellë pakënaqësi te këta të fundit të cilët me një peticion i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese, duke kërkuar nga kjo gjykatë që të vlerësojë kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë e vendimit të Kuvendit të Komunës së Prizrenit të datës 30 prill 2009.

Në ankesën e tyre, banorët e lagjes “Dardania” kanë theksuar se është shkelur e drejta e tyre kushtetuese që ka të bëjë me: “Institucionet e pushtetit lokal angazhohen për t’i garantuar secilit mundësinë që të ndikojë në vendimet që kanë të bëjnë me mjedisin jetësor ku ajo/ai jeton”.¹ Një tjetër ankesë e këtyre banorëve kishte të bënte me rrezikun e drejtpërdrejtë sipas tyre që punimi në zonën përkatëse do të mund t’u shkaktonte dëme të pariparueshme atyre.

Gjykata Kushtetuese, në vendimin e saj të datës 15 dhjetor 2009, pezulloi vendimin e Kuvendit të Komunës së Prizrenit të datës 30 prill 2009 për afat prej 3 muajsh dhe, për të njëjtën kohëzgjatje, Komunën e Prizrenit e urdhëroi që të pezullojë çdo ndërtim në këtë lagje.²

¹ Neni 52, Paragrafi 2, Kushtetuta e Republikës së Kosovës.

² http://www.gjk-ks.org/repository/docs/gjk_vendim_56-09_shq.pdf

10

Së fundi, Gjykata Kushtetuese në vendimin e saj të datës 24 mars 2010 ka vendosur që pezullimi i zbatimit të vendimit të Kuvendit të Komunës së Prizrenit përkitazi me këtë çështje të vazhdohet edhe për 45 ditë.

Prevalla


Fshati Turistik “Prevalla”, një projekt ambicioz që nga koha e qeverisjes së LDK-së, është një nga projektet më të përfolura në Kosovë. Ky projekt, pos që ka sjellë shkatërrim ambiantal në zonë, ka shkaktuar edhe përplasje të mëdha ndërmjet institucioneve qendrore dhe lokale mbi atë se kush është kompetente për këtë zonë e cila njëkohësisht është pjesë e Parkut Nacional “Malet e Sharrit”.

Zanafilla e kësaj çështjeje fillon nga data 22 qershor 2006 kur Kuvendi i Komunës së Prizrenit miratoi Planin Rregullativ Urban “Prevalla” e cila parasheh që në vetëm 17 hektarë të ndërtohen 360 shtëpi dhe objekte tjera përcjellëse. Duke qenë se zona në fjalë është pjesë e Parkut Nacional “Malet e Sharrit” dhe si e tillë është në kompetencë të Ministrisë së Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor, kjo ministri më 4 shtator 2006 ka vendosur që kompetencat e saj mbi këtë zonë t’ia bart Komunës së Prizrenit me kusht që kjo e fundit gjatë realizimit të projektit të veprojë në përputhje me Ligjin



Një nga format e shtëpive të parapara për ndërtim në Prevallë.

për planifikimin hapësinor, Ligjin për mbrojtjen e mjedisit dhe Ligjin për mbrojtjen e natyrës.



Një nga format e shtëpive të parapara për ndërtim në Prevallë.

Megjithatë, në pjesën më të madhe të ndërtimeve të filluara në këtë zonë me leje të Drejtorisë për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor të Komunës së Prizrenit, nuk u respektuan kriteret e duhura ndërtimore. Këto shkelje shtynë Kuvendin e Kosovës që të diskutojë rreth këtij projekti.

Kështu, në seancën e Kuvendit të Kosovës të datës 3 tetor 2008 u zhvillua debati rreth Fshatit Turistik “Prevalla”, debat i cili nuk përfundoi asnjëherë. Në këtë seancë, në emër të Komisionit për Bujqësi të Kuvendit të Kosovës, kryetari i këtij komisioni Lulzim Zeneli ka konstatuar se aktivitetet e zhvilluara janë në kundërshtim të plotë me Ligjin për mbrojtjen e natyrës, Ligjin për planifikim hapësinor dhe Ligjin për parkun nacional “Malet e Sharrit”.

Rekomandimet e Komisionit për Bujqësi të Kuvendit të Kosovës kanë qenë:

- Të ndërpriten urgjentisht të gjitha aktivitetet në zonën e parkut nacional “Malet e Sharrit”, veprimtaria e gurthyesve, aktivitetet ndërtimore në “Fshatin Turistik” në Prevallë, si dhe prerjet ilegale të pyjeve;

- Qeveria e Republikës së Kosovës, respektivisht, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, të shqyrtojë seriozisht gjendjen e krijuar në parkun Nacional “Malet e Sharrit” dhe të informojë Kuvendin e Republikës së Kosovës lidhur me dëmet e shkaktuara;
- Qeveria e Republikës së Kosovës, përkatësisht Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, brenda 6 muajve të hartojë planin operacional dhe të ndajë buxhet për sanimin e gjendjes në terren.

Se kriteret për ndërtim në Fshatin Turistik “Prevalla” nuk janë respektuar, po në këtë seancë ka njoftuar edhe Ministri i Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor, Mahir Yagcilar. Ai ka treguar se më 25 qershor 2008, Drejtoria e Urbanizimit dhe Planifikimit Hapësinor të Prizrenit, me një kërkesë iu ka drejtuar Ministrisë për revidimin e Planit Rregullues Urban të zonës së Prevallës, duke shtuar më tej se Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor, respektivisht Departamenti për Planifikim Hapësinor dhe Instituti i Planifikimit Hapësinor janë duke punuar në hartimin e planit hapësinor për zonën e veçantë Parku Nacional Malet e Sharrit, kështu që deri sa ta përfundojë punën, Grupi për hartimin e planit hapësinor nuk do të marrë kurrfarë vendimi.

Po në këtë seancë, në të cilin ka pas shumë diskutime të deputetëve, është kërkuar që të formohet një komision hetimor për të hulumtuar gjithë procesin në fjalë. Nga ana tjetër, deputetët janë ankuar edhe për mungesë të disa dokumenteve bazë me të cilat do të kishin një pasqyrë më të mirë për zhvillimet rreth Fshatit Turistik “Prevalla”. Kështu, në seancën e datës 3 tetor 2008, u mor vendimi që të shtyhet marrja e një

vendimi për rastin “Prevalla” për mbledhjen e radhës, në të cilin do të paraqiteshin të gjitha dokumentet e nevojshme të cilat asnjëherë nuk u saktësua se cilat janë. Që nga ajo kohë, Kuvendi i Kosovës asnjëherë nuk ka diskutuar më për Fshatin Turistik “Prevalla”.

12

Çka ndodhur ndërkohë?

Ndërtuesit e “shtëpive” në Prevallë kanë vazhduar punimet e tyre pa respektuar kushtet e kërkuara dhe pa u penguar nga askush;



Drejtorja për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor i Komunës së Prizrenit ka vazhduar me dhënien e lejeve të ndërtimit;



Po kjo Drejtori ka bërë pranimin teknik të 3 objekteve;



Ndërtimet e egra janë zgjeruar edhe në zonën përreth Fshatit Turistik “Prevala”, përsëri pa u penguar nga askush.

“Kampingu veror”

Një tjetër çështje të pa sqaruar në Prevallë, paraqet edhe “kampingu veror” në Prevallë e cila menaxhohet nga “Is Company”.

Në kohën e qeverisjes së LDK-së, drejtori i atëhershëm i Urbanizimit në Komunën e Prizrenit, Sahit Ukaj, kishte nënshkruar një kontratë dy vjeçare me këtë kompani. Sipas kësaj kontrate “Is Company” do të mirëmbante hapësirën e paraparë për vendosjen e kamp shtëpizave, për shfrytëzimin e të cilave qytetarët do të paguanin këtë kompani.



Zyrtarët e Komunës së Prizrenit kanë konfirmuar se nga Zyra e Prokurimit të Komunës së Prizrenit i është vazhduar kontrata “Is Company” për menaxhimin e kampingut, mirëpo askush nuk e di se nga kush është dhënë autorizimi për vazhdim të kontratës. Një tjetër

pyetje që lidhet në këtë mes është edhe ajo se a janë duke u respektuar kriteret e kontratës dhe cili është përfitimi i Komunës së Prizrenit dhe qytetarëve të saj nga kjo kontratë?

Raportet mes Komunës së Prizrenit dhe Institutit për Mbrojtjen e Monumenteve Kulturore në Prizren

Prizreni tashmë ka një hartë ku pasqyrohen kufijtë e Zonës së Veçantë të Mbrojtur për Qendrën Historike të Prizrenit. Aktivitetet e kufizuara brenda Zonave të Veçanta të Mbrojtura janë: ndërtimet apo zhvillimet komerciale të tilla si: strukturat ose godinat më të larta se manastiri/ kisha/monumenti kulturor që duhet të mbrohet; ndërtimi i rrugëve; ndërtimi i magazinave, punëtorive, shitoreve, restoranteve, bareve, kafeterive, hoteleve/moteleve, tezgave dhe kioskave ushqimore, stacioneve të furnizimit me karburant dhe riparimit të automjeteve, supermarketeve, klubeve të natës, apo ndonjë ndërtimi tjetër në shkallë më të gjerë në zonat rurale; b) tubimet, argëtimi dhe zbavitja publike; dhe c) urbanizimi i tokës bujqësore.³

Instituti për Mbrojtjen e Monumenteve Kulturore në Prizren ushtron kompetencat, përgjegjësitë dhe obligimet e veta në mbështetje të Ligjit për trashëgiminë kulturore si dhe me rregulloret e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, udhëzimeve administrative dhe akteve të tjera normative.

Në bazë të këtyre dokumenteve, trashëgimia kulturore përfshinë: trashëgiminë arkitekturale, arkeologjike, të luajtshme dhe shpirtërore, pavarësisht nga koha e krijimit dhe ndërtimit, tipi i ndërtimit, përfituesit, krijuesit ose implementuesit e punës. Shtrirja e ligjit duhet të jetë e përkufizuar për çështjet që ndërlidhen në mënyrë specifike me

³ Neni 6 I Ligjit për Zonat e Veçanta të Mbrojtura, http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2008_03-L039_al.pdf

14

trashëgiminë kulturore. Edhe trashëgimia kulturore që ndërlihet ose derivon nga konfesionet fetare do të jetë e qeverisur nga legjislacioni i cili rregullon statusin e komuniteteve fetare në Kosovë.⁴

Kur një aplikim për leje, për të ndërtuar një ndërtesë ose krijimtari tjetër në trashëgiminë e ditur arkeologjike, pranohet në autoritetin lokal të planifikimit dhe ndërtimit, ai aplikim parashtrohet menjëherë për shqyrtim në institucionin kompetent. Aplikuesi nuk mund të marrë lejen për të filluar punën, para se të bëhet një marrëveshje me institucionin kompetent për të ndërmarrë një studim vlerësues të trashëgimisë arkeologjike.

Institucioni kompetent (në këtë rast Instituti për Mbrojtjen e Monumenteve Kulturore) njofton autoritetin lokal për planifikim dhe ndërtim nëse aplikuesit mund t'i jepet leja.⁵

Në pajtim me nenet përkatëse të këtij ligji, Instituti për Mbrojtjen e Monumenteve Kulturore ka dhënë gjithsej 83 pëlqime për ndërtime apo restaurime në zonën e mbrojtur të Prizrenit. Sidoqoftë, dhënia e pëlqimit për planet dhe projektet e prezantuara, jo rrallë nuk respektohet nga investitorët gjatë realizimit të atyre projekteve.

Duke pas parasysh se kompetent për monitorimin e zbatimit të projekteve brenda zonave të mbrojtura është Drejtoria e Inspektoratit dhe se shume aktivitete të ndaluara sipas këtij Ligji zhvillohen në vazhdimësi në këtë zonë, duke përfshirë ndërtimet e larta, vendosja e kiosqeve si dhe klubet e natës, e shumë e shumë aktivitetet të tjera që bien ndesh me ligjin në fjalë mund të konkludojmë se Komuna e Prizrenit nuk ka përfillur kriteret e përcaktuar në pajtim me këtë ligj dhe si pasojë e kësaj kemi tejkalime të planeve origjinale të cilat edhe degradojnë pjesën të cilat tashmë edhe janë në pjesën e zonave të mbrojtura me ligj.

⁴ Neni 1.3 dhe 1.4 i Ligjit për trashëgimi Kulturore,
http://www.assemblyofkosovo.org/common/docs/ligjet/2006_02-L88_al.pdf

⁵ Neni 7.4 dhe 7.5 I Ligjit për trashëgimi Kulturore,
http://www.assemblyofkosovo.org/common/docs/ligjet/2006_02-L88_al.pdf

Antenat e telefonive mobile

Problem në vete në Komunën e Prizrenit paraqet edhe vendosja pa kriter e antenave të operatorëve të telefonisë mobile nëpër pjesë të caktuara të qytetit. Dihet se vendosja e këtyre antenave konsiderohet tejte të dëmshme për shëndetin e banorëve dhe sidomos të atyre që jetojnë në afërsi të këtyre antenave.

Drejtorja për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor është kompetente në dhënin e lejeve për vendosjen e antenave të telefonisë mobile. Mirëpo, nga ana e Drejtorisë në fjalë është konfirmuar se nuk është dhënë asnjë leje e vetme për vendosjen e tyre, edhe përkundër faktit se vendosja e tyre tani më është një fakt shqetësues, ku prania e tyre vërehet edhe në objektet shkollore.



Ndërkohë që, për largimin e këtyre antenave të vendosura pa leje, kompetent është Drejtorja e Inspektoratit, kjo drejtori ka intervenuar vetëm në dy lokalitete për heqjen e antenave të telefonisë mobile, në Lagjen Tusus dhe Terzi Mëhallë. Mirëpo ky organ nuk ka arritur të vendosë rend në këtë aspekt në pjesët tjera të qytetit, andaj edhe nuk mund të thirret në sukses.



Është nevojë e menjëhershme që Komuna e Prizrenit urgjentisht të themelojë një grup të veçantë të ekspertëve me qëllim të hulumtimit një nga një të secilit rast të vendosjes së antenave të operatorëve të telefonisë mobile nëpër pjesë të ndryshme të qytetit. Përndryshe çdo moment që kalon pa e trajtuar këtë çështje paraqet rrezik shtesë dhe të përhershëm për të gjithë qytetarët që jetojnë, punojnë, studiojnë apo relaksohen pranë këtyre antenave. Komuna e Prizrenit duhet të kthejë në vend ligjshmërinë në këtë sektor.
